

QERAM CIBAKU



Drejtor i Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nga nëntori 2013. Lindur në vitin 1968. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1992). Master për administrim-biznes. 22 vite eksperiencë pune. Në 5 vitet 2008-2013 Auditues në KLSH. Nga tetori 2012 deri në tetor 2013, Auditues i Lartë, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH. Fusha e ekspertizës: Auditimi i Financave Publike.

KLSH, OSE “WIND OF CHANGE”ⁱ

nga Qeram Cibaku

1. SAI DHE QEVERISJA SI PROBLEM.

KLSH ose institucioni suprem i auditimit shtetëror (SAI), është instrument i shërbimit shtetëror që vlerëson performancën e institucioneve publike të shtetit dhe shkallën e përgjegjshmërisë publike të zyrtarëve, shqyrton me paanshmëri dhe profesionalizëm administrimin dhe menaxhimin e kapitaleve financiare të shtetit, saktësinë dhe rregullaritetin e administrimit të buxhetit kombëtar, në raport me kriterin ligjor të pranuar si referim. KLSH inkurajon një qeverisje sa më të mirë, duke tërhequr vëmendjen e menaxherëve publikë nga qasja drejtë enklavës së ngasjes në shpërdorimin me financat dhe paranë publike dhe shkarjes në abuzivizëm, keqbërje dhe deformim të virtyteve morale e sociale.

Me pak fjalë, KLSH ballafaqon, peshon e vlerëson faktet, pozitat dhe situatat reale me parametrin-kriter, duke arritur në një përfundim të zbardhur përmes një dokumenti raportimi. Prandaj, KLSH ose SAI është teleskopi i hulumtimit të veprimtarisë së qeverisë dhe qeverisjes. Kjo ide është skalitur e formuluar më së miri në fjalimin e parë të përrurimit të Presidentit të SHBA-ve Ronald Regan (20.1.1981), se “Qeveria nuk është zgjidhja e problemit

tonë. Qeveria është vetë problemi”. Për këtë arsye, KLSH i bie barra e të qenit autoritet i besueshëm e i pavarur, i spontimit të përditshëm të veprimeve të Qeverisë, kurse audituesit e saj janë dëshmuesit dhe reporterët e cilësisë së shpenzimit të parave shtetërore dhe administrimit e mbarështimit të të mirave publike.

2. MBI AUDITIMIN PUBLIK

Studiues dhe liderë botërorë të auditimit, në mjaftë raste kanë evokuar vlerat e këtij funksioni kritik dhe vlerështues.

“Auditimi është një zanat i vyer, jetësor dhe i rëndësishëm. Mos ekzistenca e tij është një risk në vetvete. Institucionet që nuk auditohen, nuk mund tu matet sukcesi”,-theksoi presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive (Sayishtay),prof.as.dr Recai AKYEL në leksionin e mbajtur në UP Tiranës me rastin e dekorimit me titullin e lartë “Doctor honoris causa” me datën 4.6.2013.

I njëjti mesazh ,i kuruar në notat e vlerësimit për rolin e KLSH , u kumtua nga një zë tjetër brilant dhe lider i këtij profesioni Robert GIELISSE, përfaqësues i DG Budget në Komisionin Evropian. “KLSH,-nënvizoi z.Gielisse,- është transformuar nga një zjarrfikës (term i volitshëm për inspektimet), në një mundësues të sigurisë. Ai është sot syri dhe veshi i Parlamentit. SAI sot është duke lëvizur gradualisht “nga hapja e zjarrit” drejtë sigurimit dhe vlerësimit të pavarur për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike”.

Duke u mjaftuar në brendinë vetëm të këtyre dy sentencave dhe mesazheve të kapshme vlerësuese, çdo niveli lexuesi i bie në sy nderimi i pranisë dhe dakortësia me rolin e pa zëvendësueshëm të SAI-t. Mirëpo, ky angazhim i pa zëvendësueshëm , ku audituesit janë aktorë të ftuar në një pozitë mirëbesimi për të vlerësuar rregullaritetin, tërësinë, ndershmërinë dhe besueshmërinë e

llogarive dhe pasqyrave financiare të shtetit apo investigimin e akteve të kundraligjshme, shkeljeve e parregullsive, mashtrimeve e abuzimeve, etj., në moment kruciale sikur anashkalohet dhe përhumbet nga politika e ditës.

3.SFIDAT APELOJNË PËR APROVIMIN E LIGJIT TË RI TË SAI-t.

Audituesit operojnë në një mjedis politik - jo gjithmonë të mirëpritur e të vlerësuar, pasi disa konsumatorë të këtyre raporteve dhe subjekt i auditimeve, do të jenë të pakënaqur me rezultatet fundore të këtij procesi. Nevoja për të qenë transparentë dhe për të bërë publike këto raporte, por duke respektuar një akord distance nga politika ditore për çështjet e keq menaxhimit të fondeve dhe parasë publike, krijojnë shpesh vështirësi për aktivitetin e KLSH. Nëse do të bënim një persiatje të aksionit të shpallur nga Ambasada e SHBA-ve, të titulluar “*Act now*”, në kodet e kësaj disipline do të transkriptohej: Sot është koha për aprovimin e ligjit të ri të SAI/KLSH.

Vendosja në kalendarin e shqyrtimeve me precedencë dhe aprovimi i këtij drafti nuk është vetëm një imperativ, por dhe një vlerë e shtuar e Kuvendit të ri, sepse:

1.Ligji aktual nr. 8270 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, buron nga një “gurrë e thatë”, pasi ka si bazë referuese një akt të rënë nga fuqia ligjore, sikundër është ligji nr. 7491, datë 29.4.1991 ”Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”,i shfuqizuar nga Kushtetuta e Shqipërisë.

Misioni, objektivat, llojet e auditimit duhet të rishkruhen, ndryshohen e pasurohen, si dhe të shtohet vizioni i KLSH, duke reflektuar sugjerimet e vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare dhe eksperiencat e SAI-t në rajon e më gjerë. P.sh. Në vlerësimin e jashtëm të kryer nga SIGMA në maj 2009 lidhur me qëllimin është nënvizuar se “Kontrolli i Lartë i Republikës së Shqipërisë, (KLSH-ja) është i pavarur funksionalisht, operacionalisht dhe administrativisht. Kushtetuta siguron një bazë solide për funksionimin e tij.

Objektivat, fushëveprimi, kompetencat, dhe struktura organizative e KLSH-së janë përcaktuar në ligjin për KLSH (SSAI Act). Edhe pse një pjesë e madhe e këtij ligji është në përputhje me Deklaratën e Limës të INTOSAI-t dhe me standardet ndërkombëtare të auditimit, ligji ka nevojë për rregullime në lidhje me qëllimin e auditimit, si dhe kriteret për shkarkimin e kryetarit dhe për përcaktimin e statusit të stafit. Procedura e raportimit vjetor të KLSH-se mbi auditimin e saj të ekzekutimit të buxhetit gjithashtu duhet të krijohet në mënyrë të vendosur në Aktin e SSAI".

Burimi: (Albania, "External Audit Assessment", Maj 2009, pika 2, faqe 5).

2. Kambanat për përmirësime ligjore dhe forcimin e pavarësisë institucionale kanë rënë prej kohësh. Në dokumentin "SIGMA Assessment Albania, 2010", kapitulli "Public Expenditure Management and Control", nënvizohet se: "Edhe pse ligji aktual për institucionin e Auditimit të Jashtëm të Shqipërisë, institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), mbulon objektivat, detyrat, organizimin dhe kompetencat e institucionit, ndryshimet në këtë ligj janë të nevojshme. Në vitin 2009, KLSH hartoi propozimet konkrete për ndryshimin e ligjit të KLSH. Këto propozime nuk mundën të miratohen jo vetëm nga vështirësitë e shkaktuara nga zgjedhjet e fundit, por edhe nga fakti se miratimi i kësaj nisme ligjore kërkon një shumicë të cilësuar".

Kapitulli 32 i Raportit të Progresit BE-Shqipëri, 2011: Në raportin e progresit në mënyrë specifike janë identifikuar e adresuar dobësitë në progresin e Auditimit Suprem të Shtetit gjatë të kaluarës së afërme: "Ka pasur progres në fushën e auditimit të jashtëm. Një kryetar i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), u emërua nga Parlamenti në dhjetor 2011. Pas disa viteve në ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve

Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit”.

3. Meqenëse KLSH/SAI mbart detyrimin ligjor të Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm te Sektorit Publik, detyrim që buron nga Seksioni 3, pika 3 e Deklaratës së Limës,(miratuar në Tetor 1977 në Kongresin e IX-të INTOSAI-t në Lima, Peru), Standardi Atributiv Nr. 1312 “Vlerësimet e jashtme” i Institutit të Audituesve të Brendshëm (Florida, SHBA), dhe nga Neni 7 i Ligjit organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit, (nr. 8270, datë 23.12.1997, së bashku me amendimet në Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000), bëjnë domosdoshmëri përafrimin e këtyre paketave metodike dhe ligjeve bazë.

4. Ndryshimet ligjore do të korrigjojnë ngërçin terminologjik duke përafruar auditimin suprem te shtetit ne “odeonin” e terminologjisë bashkëkohore, duke inkuadruar tezat e DG Budget mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe duke shkruar konfuzionin terminologjik dhe ngarkesat që mban ligji ynë aktual për termat “kontroll” dhe “auditim”.

4. SOFRA E SINTEZAVE DHE INDIKATORËT STATISTIKORË TË KLSH.

KLSH është shndërruar në një energji pozitive. Një funksion debati dhe e thithjes së mendimit të botës akademike. Me tregues suksesi të matshëm e të krahasueshëm. Një sintezë e dinamikës së numrit të auditimeve, e gjetjeve nga zbulimet e shkeljet e ligjshmërisë dhe ato financiare, paraqitet në tabelën vijuese:

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Treguesi								
nr. i auditimeve të realizuara	161	151	146	152	150	153	152	177
Vlera e shkeljeve me dëm (milione lekë)	5,052	7,325	6,059	4,046	7,305	1614	7,023	13,522

Masa gjithsej (disiplinore e administrative)	732	1002	632	894	835	847	720	1221
Niveli i zbatimit të rekomandimeve	73 %	75%	77%	78%	75%	80%	74%	70%
Kallëzimet penale (nr rastesh)	27	32	30	32	9	5	6	40
Kallëzimet penale (nr. personash)	74	102	84	81	27	13	13	125
Nr. rekomandimeve për përmirësim legjislacioni	x	x	32	36	65	53	45	58

Duke analizuar këtë situatë statistikore, rezulton se kufiri më kulmor i gjetjeve, numri i auditimeve të kryera, kallëzimeve penale për shkelësit e ligjeve dhe masat organizative kulmon në vitin 2012.

Kjo trupë dinamike dëshmon kulturën e ndryshimit, inkurajon shkëmbimin e përvojave, të nxënit proaktiv, si dorëzanë të publikut. Për herë të parë gjatë vitit 2013, nuk u publikuan raportet e auditimit gjatë fushatës elektorale, duke ruajtur paanshmërinë dhe për të mos ndikuar në pikavarazhin e forcave garuese, përmes përdorimit të raporteve të KLSH.

Këto tregues janë dëshmi e nervit të punës. Ky nerv duhet tendosur dhe në Auditimin e Brendshëm Publik, ku ende mbizotëron një frymë përgjumje, një rutinë e stabilizuar. Nëse sjellim në vëmendje fjalët e Paulo Coelho të shpalosura përmes veprës “Alef”, se, “janë veprimet e tashme ato që do të çlirojnë të shkuarën dhe llogjikisht do të ndryshojnë të ardhmen”.

Në këtë prizëm, KLSH është shndërruar nga një stacion stanjacioni në një model proaktiv aksioni.

Literatura e shfrytëzuar:

1. INTOSAI (1977), Lima Declartaion of Guidelines of Auditing Percepts. *E arritëshme tek*

www.intosai.org/en/portal/documents/intosai/general/limaundmexicodeclaration.

2. OECD, Good Practices in Supporting Supreme Audit Institutions, Kapitulli I, faqe 25-21.
3. “Contemporary Accounting Research”, vol. 6, nr. 2-1, faqe 288.
4. European Court of Auditors, 2011 Annual Report, faqe 45.
5. O’Regan, D. et al (2003): “Internal auditing: Practical resource guide” ,John Willey & Sons, Nju York, faqe 10.
6. Buletinet peroidikë të KLSH, vitet 2005-2012.
7. Historiku i KLSH, Tiranë 2012, faqe 126-142.
8. KLSH, Raporti vjetor i performancës 2012, Tiranë 2013, faqe 7.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 12 Korrik, 2013